

Dr. Drita BAKIJA-GUNGA

GRATË NË REZISTENCËN SHQIPTARE 1945-1947

Problemi i gruas në studimet akademike

Vitet e fundit të shekullit XX karakterizohen me një depërtim të theksuar të subjektit femër në studimet akademike. Një proces i tillë mori hov të madh në SHBA, kur në universitetet kryesore të këtij vendi filluan të funksionojnë katedrat për studime femërore.

Në Evropën Juglindore, në veçanti në shkencën shqiptare, nuk i është kushtuar kujdes i duhur këtij problemi, duke e gjykuar si "gjinia tjetër", siç e quan Simon de Bovuar, njëra ndër mendimtarët kryesore të feminizmit ekzistencialist. Në mentalitetin ballkanik studiuesit e shkencave shoqërore që i janë përkushtuar me seriozitet problemit të gruas janë nënçmuar nga njerëzit jokompetentë. Studimet për çështje femërore kryesisht kanë për qëllim të gjejnë dhe të analizojnë paraqitjen e subjektit femëror në të gjitha sferat e shkencës dhe të diturisë.

Mendoj se historia e Kosovës, që ka të bëjë me subjektin femër meriton një kujdes më të madh për informimin e brezave të sotëm dhe brezave të ardhshëm, në mënyrë që historia e grave shqiptare të mos mbetet histori e heshtjes.

Në këtë punim bëhet fjalë për pjesëmarrjen e gruas shqiptare në Lëvizjen e rezistencës në Kosovë në vitet e para të Luftës së Dytë Botërore. Kjo nuk duhet kuptuar si një histori e plotë, për këtë problem, por si një përpjekje që hedh vështrimin në një periudhë të veçantë historike për Kosovën pas Luftës së Dytë Botërore.

Në mungesë të burimeve të duhura, studiuesi i kësaj periudhe, 1945-1947, dhe i këtij problemi e ka mjaft vështirë të vijë te e vërteta. Burimet historike të kësaj periudhe janë të pakta dhe të pasistemuara. Materialet e kësaj kohe ishin në shënjestër për t'iu humbur gjurmët dhe për t'u asgjësuar nga ana e regjimit në fuqi. Tërë ajo lëndë arkivore që mbeti e paasgjësuar

falë rastësisë, përbëhet prej disa fondeve të pakompletuara të gjyqeve. Prandaj, është e natyrshme se pasqyrimi i problemit të shtruar nuk mund të jetë i plotë pasi që mungojnë burime të tjera. Të dhënat që parashtrohen në këtë punim dhe përfundimi i nxjerrë prej tyre përbëjnë një përpjekje të parë në studimin e këtij problemi.

Padyshim, historia e këtyre grave është pjesë e historisë së Kosovës. Këtë punim e ndjej si borxh ndaj një brezi të veçantë, ndaj grave të Prizrenit që i kuptuan sfidat e kohës e të ngjarjeve që përkojnë me aktivitetin politik gjatë luftës së Dytë Botërore dhe menjëherë pas saj. Ato e meritojnë që vepra e tyre të ketë një vlerësim dinjitoz dhe me përkushtues për atë që bënë në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe që veprimtaria e tyre të mos mbetet histori e heshtjes.

Protestat e grave kundër mobilizimit

Rrjedhat e Luftës së Dytë Botërore dhe rrethanat ndërkombëtare pas saj ndikuan në ndarjen e popullit shqiptar. Një pjesë e konsideruar e tij u pajtua me rrethanat e krijuara, me shpresë se ato me kohë do të ndryshojnë, ndërsa pjesa tjetër ose heshti, ose vazhdoi kundërvënien në forma të ndryshme. Shqiptarët luftën për çlirim e vazhduan pa marrë parasysh rrethanat e ndërlikuara dhe rrezikun që mund të pasonte nga një veprimtari e tillë.¹

Si pjesë përbërëse e kombit edhe gratë e përjetuan mashtrimin kombëtar përballë atij ideologjik. Shkeljen e premtimeve të dhëna në kohën e Lëvizjes Antifashiste, ndalimin e përdorimit të simboleve kombëtare, si dhe përdorimin e gjuhës amnore në shkolla ato e kuptuan si ndalesë për zhvillimin shpirtëror të një kombi.

Në rajonet me probleme dhe me vështirësi të shumta gratë organizohen shumë shpejt, sepse ato e ndjejnë më thellë të keqen që mund të vijë për familjet. Gratë e Kosovës zhgënjimin e tyre me situatën politike të sapokrijuar filluan ta manifestojnë në forma të ndryshme. Kështu, më 8 mars 1945 në Gjakovë, në vend se të festojnë ditën ndërkombëtare të gruas, organizohen demonstratat e grave gjakovare.² Këto ishin demonstratat e para kundër pushtetit të ri, ku ato shprehën revoltën kundër mobilizimit. Në thelb ky organizim kishte të bënte me mashtrimin dhe zhgënjimin nga

¹ Dr. Izber Hoti, Në udhëkryeqet e historisë dhe historiografisë shqiptare, Prishtinë, 2003, 84, 92.

² Dr. Ali Hadri, Gjakova në LNÇ, Prishtinë, 1976, fq. 100, 103.

premtimet e dhëna gjatë luftës për zgjidhjen e drejtë të çështjes kombëtare.³ Natyrisht se këto demonstrata buronin edhe nga instinkti amnor, që nuk njeh sistem e ideologji kur ato janë të bindura se fëmijët e tyre keqpërdoren për t'i shërbyer një politike djallëzore. Andaj, një pjesë e madhe e grave që kishin përkrahur Lëvizjen Antifashiste dhe kishin kontribuar në sjelljen e pushtetit të ri, tani ngriteshin kundër të njëjtit.

Ngjashëm me gratë e Gjakovës vepruan edhe ato të Vushtrisë. Të pakënaqura me dhunën që po ushtrohej ndaj atyre pse guxuan të mendojnë ndryshe, për disa dukuri që u shfaqën menjëherë pas luftës, e sidomos me mobilizimin e të rinjve, ato filluan të organizoheshin për të shprehur pakënaqësinë e tyre ndaj regjimit. Në fund të marsit të vitit 1945 në shtëpinë e Hajrie Xërxës mbahet një tubim i fshehtë i grave të Vushtrisë. Në atë tubim marrin pjesë: Faire Lutfiu, Hajrie e Shehzade Novolani, Hamide Buçinca, Nona Gërguri, Myradie Badivuku, Haxhere Hoxhaxhiku, Zade Mikullovcit etj. Në tubim ishte marrë qendrim që të organizoheshin një protestë për të shprehur pakënaqësinë me veprimet e pushtetit të ri, me politikën diskriminuese ndaj shqiptarëve. Siç ishte planifikuar më parë në tubimin e fshehtë të grave në shtëpinë e Hajrie Xërxës, më 8 mars në orën 12 para ndërtesës së OZN-ës u mbledhën rreth 300 gra nga Vushtrria e rrethina. Qëllim i protestës ishte, pos tjerash, të zbardhej e vërteta për të vrarët dhe të burgosurit shqiptarë.

Kjo protestë pati jehonë në tërë Kosovën dhe i frikësoi pushtetarët. Për ta shpërndarë protestën ata përdorën dhunën dhe burgosën disa nga protestueset si Igballen, Hajrien dhe dhjetëra gra të tjera. Mirëpo, nga presioni i popullatës vendëse pjesa më e madhe e grave të burgosura u liruan, ndërsa të nesërmen u liruan edhe organizatorët e protestës. Në organizimin e tubimit të fshehtë të grave të Vushtrisë, e më vonë edhe të organizimit të protestës, kishte dhënë kontribut edhe Gjyle Bunjaku, e cila në këtë kohë ishte edhe kryetare e Frontit Antifashist të Gruas.⁴

Formimi i Komitetit të Grave Nacionaliste në Prizren

Rrethanat që u krijuan menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, padyshim që ndikuan edhe në qëndrimin dhe orientimin e grave të Kosovës, veçanërisht te femrat e moshës rinore të cilat nuk mund të qendronin

³ Deklaratë e marrë nga Hyrie Hana më 20 maj 1990, pjesëmarrëse në Lëvizjen Antifashiste, që më vonë bie në kundërshtim me pushtetin e ri dhe burgoset disa herë.

⁴ Vushtrria-Vicianë me rrethinë, Prishtinë, 2003, f. 192-193.

indiferente kur etërit, vëllezërit, të afërmit apo të dashurit e tyre pësonin në rrethanat e krijuara. Si pasojë e zhgënjimit me gjendjen e krijuar në dëm të zgjidhjes së çështjes kombëtare, në disa mjedise të Kosovës krijohen edhe Komitetet e grave, të cilat bëjnë përpjekje të organizuara për t'i kundërvënë kësaj politike.

Kështu, me iniciativën e disa individëve të Lëvizjes së rezistencës së armatosur bëhen përpjekje për formimin e Komitetit të Grave Nacionaliste të Prizrenit.⁵ Qëllimi i formimit të këtij komiteti ishte që të ndihmohej Lëvizja e rezistencës shqiptare në forma të ndryshme edhe nga gjinia tjetër.

Ideologët e kësaj Lëvizjeje e kishin të qartë se shqiptarët gjatë historisë gjithmonë e kishin respektuar pjesëmarrjen e gruas në luftërat për liri e pavarësi dhe se kontributi i saj do të ishte i një rëndësie të veçantë. Burimet e konsultuara mbështesin mendimin se Komiteti i Grave Nacionaliste i Prizrenit u formua në shtëpinë e Nesibe Zhurit në prill të vitit 1944. Ajo, pas mbarimit të klasës së parë të gjimnazit në Tiranë në mars të vitit 1944, kthehet në Prizren ku takohet me shoqet e saja dhe propagandon programin e Ballit Kombëtar, "Dekalogun", të cilin e përvetësojnë edhe shumë gra të Prizrenit.⁶

Në përcaktimin e këtyre të rejave për të vepruar në drejtim të zgjidhjes së drejtë të çështjes kombëtare padyshim ndikoi edhe situata politike që u krijua në Kosovë pas vitit 1944. Të pakënaqura me këtë situatë, një grup të rejash nga Prizreni, disa prej të cilave kishin marrë pjesë në luftë kundër fashizmit, morën iniciativën për formimin e Komitetit të Grave Nacionaliste në Prizren.⁷

Iniciatore për formimin e këtij Komiteti ishin: Nesibe Zhuri, Xhyliana Mateja, Luçije Bashota dhe Roza Mjeda. Për këtë qëllim gjatë vitit 1944 u mbajtën disa mbledhje në të cilat mori pjesë edhe Sali Zhuri, një veprimtar i dalluar i kësaj ane që i mbante lidhjet midis Komitetit të Grave të Prizrenit dhe çetave të armatosura në rrethinën e këtij qyteti. Puna e këtij Komiteti ishte përqendruar në propagandimin e ideve të Lëvizjes së rezistencës, si dhe në grumbullimin e materialeve dhe informatave të ndryshme. Anëtarët e këtij Komiteti grumbulluan, shpërndanë dhe lexuan literaturën që kishte të bënte me ngjarjet politike të kohës. Ato qëndisën edhe emblema për luftëtarët e lirisë si dhe zhvilluan veprimtari në zgjerimin e Komitetit me anëtare të reja.⁸

⁵ AK.GJyqi i Qarkut Prizren, P. 202/45

⁶ AK.Okruzni sud u Prizrenu, Odelenje, KZP,9-73.

⁷ Po aty.

⁸ AK. Fond, Okruzni sud u Prizrenu, odelenje, "K" Krivcno, 21. V. 1946.

Për një kohë shumë të shkurtër anëtarët e Komitetit të Prizrenit me veprimtarinë e tyre arritën të përvetësojnë edhe një numër të mirë të rejash nga ky qytet.

Mbështetur në të dhënat dhe njohuritë e deritashme, Komiteti i Grave Nacionaliste i Prizrenit zgjerohet, forcohet dhe organizohet më mirë në maj të vitit 1945. Në mbledhjen e zgjeruar që mbahet më 10 maj 1945, kryetare zgjidhet Xhyliana Mateja, sekretare Luçije Bashota, ndërsa arkëtare Nesibe Zhuri. Anëtarë të Komitetit ishin: Laura Smani, Çiçile Krasniqi, Roza Mjeda, Mrika Gjoka, Roza Cuki dhe Mane Shyti.⁹ Anëtarët ishin të grupmoshave dhe niveleve të ndryshme arsimore e profesionale. Shumica prej tyre ishin të reja të moshës 17-25 vjeçare. Në përcaktimin e tyre për të vepruar në drejtim të zgjidhjes së drejtë të çështjes kombëtare kishte ndikim edhe familja. Familjet e tyre ishin të lidhura ngushtë me idenë e çlirimit kombëtar dhe jetësimin e tij.

Nesibe Zhuri ishte e motra e Sali Zhurit, figurë e njohur e rezistencës shqiptare në këto anë. Ajo ishte 17 vjeçe dhe kishte të kryer dy klasa të shkollës së mesme. Shkollimin e kishte filluar në Shqipëri dhe e kishte vazhduar në Kosovë. Xhyliana Mateja ishte e motra e Seb Matejës, i dënuar bashkë me Marije Shllakun në procesin e Prizrenit. Kishte 18 vjet dhe me profesion ishte rrobaqepëse. Luçije Bashota ishte 17 vjeçe dhe nxënëse e Gjimnazit shqiptar. Çiçile Krasniqi ishte 23 vjeçe, kishte të kryer shkollën e ulët profesionale. Roza Mjeda ishte 18 vjeçe, ndërsa Mrika Gjoka 19 vjeçe dhe që të dyjat ishin me profesion rrobaqepëse. Mane Shyti 19 dhe Roza Cuki 21-vjeçare ishin amvise. Të gjitha ishin të pamartuara, me përjashtim të Laura Shmanit, me kombësi italiane, që ishte e martuar me Riza Alinë (luftëtar i rezistencës shqiptare) dhe kishte një fëmijë.¹⁰

Komiteti i Grave Nacionaliste i Prizrenit, në saje të punës së këtyre të rejave në fillim të vitit 1945 u konsolidua, u zgjerua dhe u forcua në pikëpamje organizative. Për një kohë shumë të shkurtër anëtarët e këtij Komiteti zhvilluan një sërë aktivitetesh dhe mbajtën disa mbledhje në të cilat u caktuan detyrat dhe angazhimet për punën e tyre të mëtejme. Mbledhjet e para të Komitetit u mbajtën në shtëpinë e Nesibe Zhurit dhe në vreshtat e Prizrenit. Në to diskutohej për situatën politike në vend dhe më gjerë. Po ashtu bëhej betimi para flamurit dhe caktoheshin detyrat me të cilat ngarkoheshin anëtarët e këtij Komiteti. Detyrat që shtroheshin para tyre zakonisht ishin: informimi për punën e pushtetit popullor, lëvizjet e ushtrisë jugosllave dhe informata të natyrave të ndryshme në dobi të Lëvizjes së rezistencës së armatosur. Anëtarët e këtij Komiteti kishin për detyrë të

⁹ AK. KZP, K. br. 202\45.

¹⁰ AK. KZP, 17\45, 17\46.

ndihmonin në grumbullimin dhe dërgimin e armëve të lehta dhe të municionit për luftëtarët e rezistencës në mal, si dhe gjërave ushqimore, veshmbathjes, mjeteve higjienike etj.¹¹ Për t'u kryer punët sa më me efikasitet, ato i caktuan detyrat dhe obligimet individuale lidhur me ndihmën që duhej dhënë rezistencës së armatosur. Kështu, Nesibe Zhuri kishte për detyrë të përvetësonte sa më shumë femra shqiptare myslimane për këtë çështje. Xhyliana kishte për detyrë të grumbullonte ndihma për luftëtarët dhe ato t'i dërgonte Laurës; Luçija t'i dëgjonte lajmet në radio dhe t'i informonte anëtarët e Komitetit për ngjarjet politike në vend dhe në botë, ndërkaq Roza Cuki ta mbante në fshehtësi parullën me të cilën anëtarët e Komitetit mund të dilnin nga Prizreni, në mënyrë që më lehtë të takoheshin për t'i shkëmbyer informatat me luftëtarët në mal.

Veprimtaria e Komitetit të Grave Nacionaliste të Prizrenit ishte e një rëndësie të vacantë, sepse në këtë kohë të vështirë për luftëtarët e rezistencës së armatosur, informatat që mirreshin nga anëtarët e tij ndihmuan mjaft në orientimin e sigurt të luftëtarëve për ndërmarrjen e aksioneve. Veprimtaria e grave në çështjen e informimit në këtë kohë ishte më me pak rrezeje ngase ato ishin të mbuluara dhe nuk mund të hetoheshin lehtë nga organet e sigurimit. Në situatën në të cilën ndodhej rezistenca e armatosur shqiptare kohë pas kohe çështja e ushqimit, e veshmbathjes, e pajisjes me mjete higjienike e materiale të tjera, ishte e një rëndësie të veçantë.¹²

Për kontributin e dhënë në këtë drejtim dallohej Xhyliana Mateja, e cila për organet e pushtetit të ri ishte e njohur si nacionaliste e rrezikshme, që kishte punuar me besnikëri e përkushtim në këtë drejtim edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ndërkaq, puna e Nesibes (pas kthimit nga Tirana punonte në ilegalitet) dhe e Laurës ishte zhvilluar në drejtim të bashkimit dhe të forcimit të rezistencës së armatosur.¹³

Gjatë një bisede me disa veprimtare të gjalla të këtij Komiteti, i pyeta se ku ishte dallimi midis jush dhe grave të NDSH-së, sepse veprimtaria e tyre ishte e ngjashme, e ato u përgjigjën: nuk është aspak e rëndësishme se si njihen ose emërtohen ato në burimet historike, apo se si do ta emërtoj unë grupin e tyre, më rëndësi është se ato ishin kundër ideologjisë komuniste, të cilën e identifikojnë me sllavizëm. E rëndësishme është se ato me veprimtarinë e tyre ishin për bashkimin e trojeve etnike dhe për një sistem demokratik pluralist. Kjo, thanë ato, ishte më e rëndësishmja për Komitetin

¹¹ AK.KZP, -br. 17\45, kz- br,381\45.

¹² AK. K. br. 202\45.

¹³ AK. KZP. 17\45.

e Ballit Kombëtar të grave të Prizrenit.(siç e quanin Komitetin e femrave D.G).¹⁴

Femrat që ishin anëtare të Komiteti të Grave të Prizrenit përkrahën atë pjesë të shqiptarëve të cilët vazhduan luftën për çlirim pas vitit 1944, pa marrë parasysh rrethanat e ndërlikuara dhe rrezikun e një veprimtarie të tillë. Në fakt, puna e anëtareve të këtij Komiteti ishte vazhdimësi e punës së shumë grave që gjatë historisë vepruan në drejtim të zgjidhjes së drejtë të çështjes kombëtare.

Që në fillim të veprimtarisë së tyre lëvizjet e anëtareve të Komitetit të Grave Nacionaliste të Prizrenit ishin në shënjestër të organeve të sigurimit dhe përcilleshin me kujdes nga punonjësit e këtij shërbimi. Pjesa më e madhe e anëtarëve të Komitetit përbëhej nga të rejtat shqiptare katolike të cilat lëviznin lirshëm në qytet pa mbulesën islame, gjë që ua lehtësoi punën organeve të sigurimit për t'u informuar më lehtë për veprimtarinë e tyre dhe për t'u zbuluar aktiviteti i tyre politik pas një kohe të shkurtër.¹⁵

Prizreni, njëra ndër qendrat e rezistencës mbarëshqiptare, po përjetonte çaste të rënda sepse Brigada II kosovare, që shpalli shtetrrethimin në qytet, arrestoi gati të gjithë burrat që i gjeti në shtëpi dhe i pushkatoi 70 prej tyre. Në shënjestër të OZN-ës u vunë veprimtarët dhe pjesëtarët e familjeve të njohura shqiptare. Për të realizuar më me efikasitet qëllimet e veta ndaj Lëvizjes së rezistencës shërbimi sekret krijoi një rrjet të gjerë spiunësh që përpilonin listat e njerëzve që duhej arrestuar.¹⁶ Kësaj liste nuk i shpëtuan as anëtarët e Komitetit të Grave Nacionaliste të Prizrenit.

Arresteime e hetime kundër anëtareve të Komitetit

Në listën e përpiluar nga organet e sigurimit për arrestim ishte edhe Nesibe Zhuri, e cila jetonte në ilegalitet, si edhe veprimtarët e tjerë të Komitetit. Përpjekjes së parë të organeve të sigurimit për ta arrestuar Nesibja i shpëtoi duke u fshehur në tavanin e shtëpisë. Herën e dytë ajo qëndroi në shtëpi dhe pas një jave u vetëdorëzua dhe u burgos më 8.VIII.1945. Në burgun hetues të Prizrenit qëndroi afro tre muaj. Pas shumë presioneve, psikike dhe fizike që i bëhen nga agjentët e OZN-ës, ajo jep deklaratën e parë për veprimtarinë e saj më 25.VIII.1945.

¹⁴ Deklaratë e marrë në tetor të vitit 2000 nga Çeçile Krasniqi, anëtare e Komitetit të Grave të Prizrenit.

¹⁵ AK. K. br. 202/45.12 oktoibar 1945 god. Prizren.

¹⁶ M. Shatri, Kosova në Luftën e Dytë Botërore 1941-1945, Prishtinë, 1997, 234-240.

Sipas të dhënave të shërbimit sekret të Prizrenit, Nesibe Zhuri ishte njëra ndër femrat e pakta të arsimuara të Prizrenit. Në moshën 17 vjeçe, pos gjuhës amnore ajo njihje edhe dy gjuhë të huaja: turqishtën dhe serbishtën. Në vitin 1941\42 ishte në Tiranë ku kreu klasën e parë të gjimnazit, ndërsa vitin të dytën e vijoi në Prishtinë në vitin shkollor 1943/44 së bashku me të vëllain Sali Zhurin. Shkollimin e mëtejshëm Nesibja nuk e vazhdoi ngase pritej ardhja e partizanëve dhe shkollat përkohësisht u mbyllën.¹⁷

Sa ishte nxënëse në Tiranë ajo ishte përkrahëse e ideologjisë komuniste. Ndikim për këtë përcaktim pati shoqja e saj Teonora Trebicka nga Korça. Me të ajo për çdo javë zhvillonte një aktivitet të dëndur për ta ndihmuar Lëvizjen Antifashiste. Për këtë qëllim mbledhjet mbaheshin në shtëpinë e Teonorës. Edhe pse profesorët e gjimnazit të Tiranës ishin të njoftuar për këtë veprimtari politike që zhvillonin nxënësit, nuk i pengonin në zhvillimin e një aktiviteti të tillë.

Me ardhjen e saj në Gjimnazin e Prishtinës gjërat ndryshuan për shkak të rrethanave politike që ishin krijuar në këtë vatrë arsimit. Në Gjimnaz vepronin grupe të nxënësve që u përkisnin rrymave të ndryshme, si ajo nacionaliste dhe komuniste. Në krye të lëvizjes nacionaliste të të rinjve ishte Luan Gashi. Në këtë kohë Nesibe Zhuri ende kishte bindje majtiste (komuniste) dhe bëri përpjekje për të kontaktuar me Vahide Kabashin, mirëpo meqë vëllai i saj ishte djathtist, nuk patën besim në të. Kështu ajo edhe nën ndikimin e të vëllait filloi të punojë për organizatën "Balli Kombëtar", ideolog i së cilës ishte Mit'hat Frashëri. Leximi i literaturës, broshurave, si dhe gazetave mujore siç ishte "Çka flet Korça", që vinin nga Tirana në rrugë gjysmilegeale, i dhanë njohuri për këtë organizatë, ndërsa programi i "Ballit Kombëtar" "Dekalogu", në të cilin flitej për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë në një shtet demokratik me të drejtat e qytetarëve, ia forcoi edhe më tepër bindjen se duhej të punohej në këtë drejtim.

Mirëpo, në këtë kohë Nesibja nuk i takonte asnjë krahu politik dhe nuk kishte njohuri për ndonjë organizatë femrash me të cilat do të zhvillonte ndonjë veprimtari në këtë drejtim.¹⁸

Në mars të vitit 1944 Nesibja kthehet në Prizren, ku pas një muaji takohet me të vëllain Salihun. Me të bisedojnë për situatën politike në vend dhe pozitën e vështirë të shqiptarëve. Pas kësaj bisede, me udhëzimin e të vëllait ajo merr për detyrë të formojë organizatën e grave nacionaliste. Kështu edhe filloi puna në organizimin për formimin e Komitetit të Grave të Prizrenit. Për këtë qëllim ajo vuri kontakt me Luçije Bashotën të cilën e informoi për qëllimet e organizimit të këtij Komiteti dhe e pajisi me

¹⁷ AK. nr. dok. 17\45.

¹⁸ Po aty.

literatureën propagandistike për këtë qëllim. Luçia e informon se në Prizren ka plot të reja që mendojnë të veprojnë për zgjidhjen e drejtë të çështjes kombëtare, por nuk dinë se si të organizohen. Ajo i tregoi Nesibes edhe për femra të tjera që ishin të interesuara të punonin në këtë drejtim, si Xhyliana Matejën dhe Roza Mjedën.

Pas një muaj qëndrimi në konviktin e Prishtinës Nesibja kthehet në Prizren ku kontakton shoqet e saja të idealit me të cilat bisedat kryesore i kishin për situatën politike në vend. Kështu, pas një kohe Nesibja, Xhyliana, Roza dhe Luçia vendosin që në prill të vitit 1944 të mbajnë mbledhjen e parë në shtëpinë e Nesibe Zhurit në Prizren, që e organizoi dhe e udhëhoqi Nesibe Zhuri.¹⁹ Në atë mbledhje, mes tjerash, u diskutua për situatën politike në vend, u lexua "Dekalogu"- program i Ballit Kombëtar, si dhe iu caktuan detyrat anëtarëve të Komitetit për të punuar sa më shumë në përfshirjen dhe organizimin e grave në dobi të rezistencës së armatosur nën parullën "luftë kundër të gjithë atyre që duan ta pushtojnë Kosovën".

Për punën e tyre anëtarët e këtij Komiteti ishin të obliguara të informonin njësitet e armatosura që gjendeshin në mal. Meqë lidhja bëhej nëpërmjet të vëllait të saj, Nesibja i raportonte atij për punën e bërë në Komitetin e Grave Nacionaliste të Prizrenit. Ai e inkurajonte Nesiben për punën e bërë dhe e këshillonte për të vazhduar edhe më tej në këtë drejtim.

Në deklaratën e dhënë në hetuesi, Nesibe Zhuri, mes tjerash, thotë: "Në mbledhjen e dytë që pas dy javësh e mbajtëm në vreshtat e Prizrenit ne të katërtat dhe në prani të vëllit tim Sali Zhurit, jemi betuar në flamur se do të punojmë për lirinë e Kosovës". Në Prizren në atë kohë ajo ishte takuar shpesh me Qazim Bllacën, të cilin e kishte kushëri. Me të kishte biseduar për çështje private, deklaroi ajo.²⁰ Në hetuesi ajo po ashtu pohon se bashkë me të vëllain Salihun ishin nisur për në Shkodër kur partizanët ende nuk ishin hyrë në Prizren. Udhëtimi kishte zgjatur dy ditë deri në Shkodër sepse gjatë rrugës kishin sulmuar avionët anglezë. Aty kishin qëndruar afro një muaj pa kontaktuar me askend, e më pas partizanët i kishin burgosur që të dy. Pas lirimit nga burgu ajo kthehet në Prizren më 10 dhjetor 1944. Një kohë qëndron në shtëpi, jeton në ilegalitet dhe nuk iu lajmërohet organeve të pushtetit.²¹

Burimet e konsultuara mbështesin mendimin se veprimtaria politike e Nesibe Zhurit fillon qysh kur ishte nxënëse e Gjimnazit në Tiranë. Këtë veprimtari ajo e vazhdon edhe në Kosovë. Deri në prill të vitit 1945 nuk zhvilloi asnjë aktivitet politik. Në maj të atij viti merr një letër nga Nijazi

¹⁹ Po aty.

²⁰ Po aty.

²¹ AK Procesverbal i datës 25.VIII.1945, AK br. 497.

Alushani, në të cilën shkruante se ajo duhet t'i organizonte gratë për t'i ndihmuar ata të cilët ishin të pakënaqur me pushtetin e ri dhe që luftonin për bashkimin e trojeve etnike. Pas dy javësh edhe nga Salihu merr një letër tjetër në të cilën ai e këshillonte për të ndihmuar Lëvizjen e rezistencës. Për këtë ajo e njofton Xhyliana Matejën, e cila shpreh dëshirën të ndihmojë në organizimin e grave. Të dyjat u pajtuan se për këtë duhej informuar Luçijen dhe disa shoqe të tjera për të cilat ishin të bindura se do të punonin në këtë drejtim. Përjashtim bënte Roza Mjeda sepse ajo ishte partizane dhe anëtare e Partisë. Pas bisedës me Xhylianën, Nesibja vazhdon punën rreth organizimit dhe vënies së lidhjeve me luftëtarët e rezistencës. Kështu, ajo takohet me të vëllain afër Dushanovës, nga i cili merr udhëzime se si duhet të ndihmohen luftëtarët e rezistencës.²²

Pas këtij takimi Nesibja vë kontakte me Laurën dhe gra të tjera me të cilat bisedojnë për zhvillimin dhe zgjerimin e aktivitetit politik të këtij grupi të grave të Prizrenit për t'i ndihmuar luftëtarët e Levizjes së rezistencës.

Sipas direktivave të Nesibes, të gjitha ndihmat e grumbulluara duhej të dërgoheshin te Laura e ajo pastaj t'i grumbullonte dhe nëpërmjet lidhjeve t'i dorëzonte në mal. Pas bisedës me Xhylianën dhe Luçijen për situatën politike në vend morën vendim që më 10 maj 1945 të organizonin një mbledhje për të cilën duhej të informoheshin gratë e Prizrenit që duan të kontribuojnë në këtë drejtim. Të dhënat dëshmojnë se organizatore e mbledhjes së parë të grave të të Prizrenit ishte Nesibe Zhuri. Këtë mbledhje e hapi Luçija, e cila foli për kushtet dhe rrethanat e krijuara në Prizren dhe për mashtrimin që po i bëhej popullit shqiptar nga ana e pushtetit popullor. Në mbledhje bëhet pranimi i anëtareve të reja në Komitetin e Grave Nacionaliste të Prizrenit. Për të qenë anëtare e Komitetit duhej bërë betimin para flamurit kombëtar. Meqenëse flamur nuk kishte, Nesibja sugjeron që me dorë në zemër të bëhej betimi, teksti i të cilit ishte: "Unë betohem në flamurin shqiptar se do të punoj për lirinë tonë, do të luftoj kundër partizanëve dhe se kurrë nuk do të tradhtoj idenë tonë". Më pas ajo i njoftoi anëtarët e reja të këtij Komiteti me detyrat që i presin. Si organizatore e mbledhjes së parë të Komitetit të Grave Nacionaliste të Prizrenit, Nesibja deklaroi para të pranishmeve se ka mjaft njohuri për punën organizative dhe politike. Njëherësh i këshillon anëtarët e reja të Komitetit që të punojnë deri në frymën e fundit për lirinë dhe të drejtat e shqiptarëve. Në vazhdim të mbledhjes u zgjodh udhëheqja e këtij Komiteti me Xhyliana Matejën kryetare, sekretare Luçije Bashota, ndërsa arkëtare Nesibe Zhuri. Kryetarja kishte për detyrë të informonte luftëtarët e rezistencës për punën e Komitetit.

²² AK. nr. 497.

Mbështetur në burimet e konsultuara të këtij Komiteti, rezulton se në fillim luftëtarët e Lëvizjes së rezistencës nuk ishin shumë të kënaqur me punën e anëtareve të Komitetit. Kjo vërtetohet edhe nga hetuesia që zhvillohet ndaj Nesibe Zhurit, e cila deklaroi se nuk e di se si janë realizuar detyrat e parashtruara, ngase veprimtaria e tyre ishte në shënjestër të organeve të UDB-së.

Nga materialet e hetuesisë shihet se Nesibja gjatë veprimtarisë së saj bashkë me Laurën kishin mbajtur kontakte të rregullta me luftëtarët në mal. Ajo i kishte njoftuar në vazhdimësi për situatën politike në vend, si dhe për aktivitetet e Komitetit të Grave Nacionaliste të Prizrenit. Prej ideologëve të Lëvizjes kishin marrë udhëzime se si duhej të zhvillohej puna në Komitetin e Grave. Edhe në hetuesi ajo asnjëherë nuk e mohoi se kishte mbajtur korrespondencë me luftëtarët në mal, me pseudonimin "Lume" dhe se kishte ndihmuar rezistencën së armatosur me ushqim e veshmbathje.

Nga hetuesia kuptojmë po ashtu se ajo kishte pasur edhe disa takime me Riza Aliun, i cili e kishte informuar se për çështjen shqiptare do të ndihmojnë anglezët. Njëherësh ai e kishte këshilluar që të bashkpunonte ngushtë me gruan e tij Laurën në drejtim të zgjidhjes së çështjes shqiptare.

Nga të dhënat e procesit gjyqësor të mbajtur në Prizren kundër anëtareve të Komitetit të Grave Nacionaliste, rezulton se Nesibja kishte një qëndrim dinjitoz, që e dëshmojnë edhe fjalët e saja para trupit gjykues: "Unë me dorën time i kam qëndisur 40 emblema për luftëtarët dhe këto nuk i kanë bërë shoqet të cilat akuzohen për këtë."²³

Prej anëtarëve të Komitetit të Grave Nacionaliste ndër të parat burgoset Laura Shmani, me 15 VIII 1945. Në dokumentet e procesit gjyqësor kundër saj i gjejmë këto shënime: E lindur në Parmë-nga babai Ygo dhe nëna Emilije, italiane e martuar me Riza Aliun, amvise, feja katolike, me bazë materiale të dobët, e padënuar, jeton në Prizren, nënë e një fëmije. Ka qenë anëtare e organizatës fashiste në Prizren. Menjëherë pas luftës burri i saj bashkohet rezistencës së armatosur shqiptare. Ajo merr pjesë në organizimin e Komitetit të parë të Grave të Prizrenit. Pas luftës nuk u largua nga Prizreni, edhe pse kishte mundësi të shkonte në Itali. Punoi sipas udhëzimeve të burrit për ta ndihmuar Lëvizjen e rezistencës nëpërmjet organizimit të Komitetit të Grave të Prizrenit.

Në të dhënat e organeve të Sigurimit Shtetëror për të gjejmë, mes tjerash, edhe këtë shënim: "E rrezikshme për pushtetin e ri popullor sepse nuk është e singertë".²⁴

²³ AK Okruzni Sud u Prizrenu, Procesverbali i datës 27.VIII.1945.

²⁴ AK, Dok. nr. 26\47.

Pas një muaj qëndrimi në burgun hetues të Prizrenit ajo mirret në pyetje në zyrat e UDB-së për Kosmet më 26 VIII 1945. Në hetuesi pranon se ka mbajtur korrespondencë me burin e saj në mal, të cilin e kishte informuar për ngjarjet politike, si dhe e kishte ndihmuar me ushqime, veshmbathje e armatim. Po ashtu, ajo pohon se në Komitetin e Grave Nacionaliste të Prizrenit ka punuar sipas udhëzimeve të bashkëshortit. Nesiben e ka njohur tri javë para se të mbahej mbledhja e parë e Komitetit dhe prej asaj kohe kishte mbajtur vazhdimisht kontakte me të.²⁵

Pas burgosjes së Laurës dhe Nesibes burgosen edhe anëtarët e tjera të Komitetit. Ato mbahen në hetuesi afro tre muaj në burgun e Prizrenit. Në fillim për to ishte caktuar gjykimi për 20 shtator 1945, në ditën kur duhej të dilte para gjyqit grupi i Halim Spahisë. Mirëpo, prokurori Ali Shukriu kërkon që proqesi gjyqësor kundër të pandehurave Laura Shmanit, Nesibe Zhurit, Xhyliana Matejës, Mane Shytit, Mrika Gjokës dhe Roza Cukit të caktohej për 22 tetor ngase ka të dhëna të reja për punën e tyre.²⁶

Në bazë të propozimit të Prokurorit Publik për Kosovë e Metohi, aprovohet vendimi për tërheqjen e aktpadisë me numër 95/45 kundër të pandehurave me kusht që gjykimi kundër tyre të mbahet sipas akpadisë që do ta ngrisë Prokurori Publik.²⁷

Në burimet e konsultuara të hetuesisë dhe të proceseve gjyqësore gjejmë këto shënime për Xhyliana Matejën: E bija e Tomës dhe Palinës, 18-vjeçare, me profesion rrobaqepëse, e pamartuar, feja katolike, shqiptare, shtetase jugosllave, me bazë materiale të dobët, e pamartuar.

Deklaratat e dhëna në hetuesi e në procesin gjyqësor dhe ballafaqimet me shoqet e saja të idealit kanë përafërsisht këtë përmbajtje. Xhyliana pranon se në fillim ishte anëtare e më vonë edhe kryetare e Komitetit të Grave të Prizrenit. Ajo kishte marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit në të cilat janë caktuar detyrat me qëllim që të ndihmohen luftëtarët e rezistencës në mal. Ajo edhe para organeve të hetuesisë pranon se kishte qenë e zgjedhur kryetare e Komitetit, por me qëllim që barrën më të madhe t'ia ngarkojë vetes dhe t'i lehtësojë sa më shumë anëtarët e tjera të këtij Komiteti, deklaronte se shumica prej tyre ishin pasive dhe nuk përfilleshin shumë urdhërat e saj. Dhe, për këtë pasivitet shumica prej anëtarëve ishin kritikuar.

Burimet që kemi mbështesin mendimin se veprimtarët e këtij Komiteti për ta ruajtur konspiracionin kishin pasur edhe pseudonimet përkatëse.²⁸ Në

²⁵ AK Oblasni Narodni Sud. Procesverbal i datës 26 VIII 1945, Prizren.

²⁶ AK. Okružni Sud u Prizrenu, OBL,- KZP-br.17/45 16 AVGUST 1946.

²⁷ K. br. dok. 339/1, 19 X 1945.

²⁸ AK, KZP,17/45. 17/46. K. br. 202/45.

materialët e procesit gjyqësor për Luçije Bashotën gjenden deklaratat e dhena gjatë qëndrimit të saj në hetuesi. Sipas tyre del se ajo ka marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit të Grave të Prizrenit në shtëpinë e Nesibe Zhurit, mirëpo nuk ka pasur ndonjë funksion me rëndësi dhe se me punën e saj nuk është dalluar. Në hetuesi Luçia pranon se disa detyra i ka kryer me përpikëri, siç ishte rasti me dërgimin e armëve të lehta. Ajo po ashtu pranon se tri revole ia kishte dhënë Jak Gjonit dhe se ai ia kishte dorëzuar Luz Ndrecit, mirëpo nuk kishte njohuri për lidhjet e tyre në mal. Në deklaratat e saja në hetuesi ajo pohon se përveç armëve e kishte dorëzuar edhe një makinë shkrimi, ngase kishte pasur frikë ta mbante në shtëpi, duke mos konsideruar se kështu bënte ndonjë vepër penale. Organet e hetuesisë përdornin metoda të ndryshme për të marrë sa me shumë informata dhe për këtë qëllim përdorëshin edhe metodat e ballafaqimit me anëtarët e këtij Komiteti.”.²⁹

Edhe Roza Mjeda në hetuesi dhe në procesin gjyqësor pranon se ka marrë pjesë në mbledhjen e Komitetit të Grave Nacionaliste të Prizrenit të mbajtur në shtëpinë e Nesibe Zhurit. Për t’i ndihmuar luftëtarët në mal ajo kishte dorëzuar katër bomba të cilat, siç deklaroi, i kishte gjetur në valixhen e kryetarit të Komunës i cili kishte banuar në shtëpinë e saj. Përveç kësaj, ajo kishte dorëzuar edhe disa fishekë dhe, për t’u mbrojtur, deklaroi se nuk i është kujtuar se këto duhet t’ia dorëzojë pushtetit.” Menjëherë pas luftës ajo kishte qenë anëtare e Organizatës së Rinisë Komuniste. Mirëpo, duke parë rrjedhat e kohës dhe rrethanat e pavolitshme që ishin krijuar për shqiptarët nga pushtetarët e rinj ishte zhgënjyer si shumë shqiptarë të tjerë në Kosovë.

Para trupit gjykues doli edhe anëtarja tjetër e Komitetit të Grave të Prizrenit Roza Cuki. Në hetuesi ajo kishte pranuar se i kishte ndihmuar luftëtarët e rezistencës shqiptare materialisht. Këtë punë e kishte bërë nëpërmjet Komitetit të Grave Nacionaliste të Prizrenit, por se pas kësaj ndihmese kishte lënë këtë aktivitet. Ajo pohon se gjatë LDB-së kishte punuar në postë, si telefoniste, mirëpo më vonë e kishin larguar nga puna si të padëshireshme. Para trupit gjykues Roza deklaroi me ironi se “nuk e kishte të qartë se njeriu mund të dënohet për disa sapuna që kanë vlerë higjienike”.³⁰

Në procesin gjyqësor të Prizrenit kundër anëtareve të Komitetit të Grave Nacionaliste, para trupit gjykues Çeçile Krasniqi deklaroi se asnjëherë nuk kishte marrë pjesë në asnjë mbledhje të këtij Komiteti. “Është e vërtetë se jam betuar në flamur se nuk do ta tradhtoj Nesiben dhe Laurën dhe të afërmit e tyre”. Para trupit gjykues ajo deklaroi po ashtu se me shoqet e saja nuk kishin biseduar asnjëherë për politikë, se nuk kishte qenë në mal dhe as

²⁹ Po aty.

³⁰ Po aty.

që kishin pasur lidhje me luftetarët e rezistencës. Mirëpo, deklaratat e dhëna në hetuesi dhe para trupit gjykues ishin në kundërshtim me njëra-tjetrën. Në ballafaqim me deklaratat e dhëna në hetuesi ajo pranon para trupit gjykues se i kishte nënshkruar me dhunë ato ngase nuk kishte pasur njohuri për përmbytjen e tyre. Kjo është e kuptueshme kur dihen metodat e njerëzve profesionistë që përdoreshin në hetuesi për të ardhur te informatat e nevojshme për ta.³¹

Njëra ndër anëtarët e Komitetit të Grave Nacionaliate të Prizrenit ishte edhe Mane Shyti. Në deklaratën e dhënë në hetuesinë e parë me 8.VIII.1945 në lokalet e UDB-së, ajo pranon se kishte marrë pjesë në mbledhje të Komitetit. Me atë rast Nesibe Zhuri i kishte dhënë për detyrë të grumbullonte municion për t'i ndihmuar luftetarët e rezistencës kombëtare. Ajo nuk e kishte pranuar një detyrë të tillë dhe se me asgjë nuk e kishte ndihmuar Komitetin e Grave në Prizren. Këtë deklaratë e përsërit edhe para trupit gjykues që mbahej në Prizren.³²

Në deklaratën e dhënë në hetuesi dhe gjatë procesit gjyqësor e pandehura Mrika Gjoka pranon se është shoqëruar me Roza Cukin dhe se bashkë me të ka kontaktuar me Nesiben. Ajo deklaron se e kishte bërë betimin para flamurit, por nuk kishte zhvilluar ndonjë aktivitet tjetër politik, bile mohon se kishte njohuri për ekzistimin e Komitetin të NDSH-së në Prizren.

Procesi gjyqësor dhe dënimet

Pas përfundimit të seancës kryesore dhe shqyrtimit të materialit provues, Gjykata konstaton se të pandehurat Laura Shmani, Nesibe Zhuri, Luçije Bashota, Xhyliana Mateja, Roza Mjeda dhe Roza Cuki në fillim të muajit maj të vitit 1945 kanë formuar Komitetin e Grave Balliste të Prizrenit me ndihmën e Sefedin Hajdinit, i cili jetonte në Prizren. Ai kishte ardhur me detyrë nga Lëvizja e rezistencës për të formuar Komitetin e Grave Nacionaliste të Prizrenit. Pas formimit të këtij Komiteti, ai ishte arratisur në mal, dhe kishte vazhduar veprimtarinë e tij në këtë drejtim.

Gjykata kishte konstatuar se ishin mbajtur shumë mbledhje nga anëtarët e këtij Komiteti. Të pandehurat, sipas kësaj gjykate, në një nga këto mbledhje kishin formuar Komitetin e Grave Balliste (siç thonë ata) me qëllim që të ndihmonin "bandat" e arratisura në mal të cilat luftonin pushtetin. Po sipas kësaj Gjykate, organizatorët kryesorë për formimin e

³¹ Po aty.

³² AK, Deklaratë e marrë në hetuesi dhe në zyrat e OZN-s, 8 gusht 1945.

këtij Komiteti kishin qenë të pandehurat Laura dhe Nesibja, të cilat me aktivitetin e tyre propagandistik kishin shpjeguar qëllimin e kësaj organizate.³³

Gjykata po ashtu mbështetet edhe në deklaratën e Nesibes, e cila pranon se për të qenë anëtarë e këtij Komiteti, se ishte dashur të bëhej betimi para flamurit kombëtar me këto fjalë: "Betohem në Flamurin tonë shqiptar së do të punoj për lirinë tonë dhe se do të luftoj nga të gjitha anët kundër partizanëve dhe kurrë nuk do ta trathtoj idealin tonë". Trupi gjukues gjatë gjykimit e përdori si argument edhe deklaratën e Luçije Bashotës, sipas së cilës, pas betimit në flamur ishte zgjedhur Këshilli i Komitetit. Ky organ jepte direktiva për punë dhe informohej për aktivitetin e anëtareve nga terreni.

Në arsyetimin e kësaj gjykate për veprimtarinë politike të Laura Shmani thuhet se ajo ia kishte ngarkuar vetes për detyrë që t'i ndihmonte në çdo mënyrë luftëtarët e rezistencës në mal. Të gjitha materialet e grumbulluara për këtë qëllim ajo i dërgonte nëpërmjet lidhjeve të saja në mal. Në bazë të të dhënave që kishte, Gjykata konstaton po ashtu se të pandehurat Roza Mjeda dhe Roza Cuki kanë pasur për detyrë të mblidhnin informata dhe materiale të ndryshme për t'ia dorëzuar Laurës.

Gjykata ka konstatuar po ashtu se të pandehurat gjatë veprimtarisë së tyre kanë dërguar informata të ndryshme që iu kanë shërbyer mirë atyre të malit për orientime dhe për aksione të ndryshme. Sipas pohimeve të Nesibes dhe Laurës në hetuesi, Gjykata ka konstatuar se ato në muajin maj të vitit 1945 kanë shkuar në mal dhe janë takuar me "bandat" për t'u këshilluar për punën e mëtejme të këtij Komiteti; se të pandehurat Nesibe, Xhyliana, Luçije dhe Roza qysh në pranverën e vitit 1944 kanë pranuar të punojnë për Organizatën e Ballit Kombëtar, të shumzojnë materialet propagandistike të kësaj organizate, të qëndisnin simbolet balliste dhe t'i bindnin vajzat e tjera që të punonin për këtë organizatë.³⁴

Sipas pohimeve të të pandehurave, si gjatë hetuesisë ashtu edhe gjatë seancës kryesore, gjyqi i ka refuzuar si të pavërteta mbrojtjet e të tyre. Në bazë të fakteve të grumbulluara gjyqi konstaton: "Në veprimet e të pandehunave të naltë permenduna egzistojnë të gjitha elementet themeltare të parapame me nenin 6 të ligjes të fajit kundra popullit dhe shtetit, me kene se, organizata e tyne ishte pjesa e pa ndashme e organizates së Ballit e cila ka pasë për qëllim qe me anen e violences me e rrezue rregullin shtetnuer qe asht."

³³ AK.Oblasni Narodni Sud, Aktgjykimi i datës 23 XI 1945.

³⁴ Po aty.

Me rastin e caktimit të dënimit të pandehurave të lartpërmendura, gjykata veç e veç ka caktuar shkallën e përgjegjësisë së tyre dhe ka konstatuar se:

E pandehura Laura, si fashiste dhe gruaja e armikut Ali Riza, me vetëdije ka vepruar për këtë organizatë; se ka qenë lidhja kryesore dhe e përhershme midis Komitetit të Grave dhe atyre në mal. Në punën e saj në këtë drejtim ka qenë shumë aktive dhe i ka kryer me përpikëri detyrat e marra duke i informuar në vazhdimsi të arratisurit në mal për situatën në Prizren. Me anë të lidhjeve ajo i ka dërguar në mal materialet e grumbulluara dhe është takuar disa herë me ata të malit, prej të cilëve ka marrë udhëzime për punën e mëtejshme për këtë organizatë;³⁵

E pandehura Xhyliana Mateja është zgjedhur kryetare e Komitetit dhe ishte e njohur, e sprovuar, besnike dhe simpatizante e organizatës balliste qysh në kohën e Luftës së Dytë Botërore. Ajo në kryerjen e detyrave të parashtruara ka qenë shumë aktive, ka punuar me përkushtim në grumbullimin e materialeve për ata në mal, si dhe në drejtim të përvetësimit të sa më shumë grave në këtë organizatë;³⁶

E pandehura Luçije Bashota ka qenë anëtare e Komitetit të Grave Balliste dhe njëherësh anëtare e Bashkimit të Rinisë Komuniste të Jugosllavisë. Ajo ka punuar në grumbullimin e armëve dhe të materialit tjetër për ata në mal;

E pandehura Nesibe Zhuri ka qenë anëtare dhe arkëtare e këtij Komiteti dhe e ka ndihmuar rezistencën e armatosur shqiptare. Mirëpo, si rrethanë letësuese gjyqi e merr moshën e saj të re dhe ndikimin që ka pasur i vëllai Sali Zhuri.³⁷

Mbas mbajtjes së seancës kryesore publike në Prizren me datë 22-23 tetor 1945 në praninë e të akuzuarave dhe të zëvendësprokurorit publik për Kosmet, Radoje Vukiçević, dhe mbasi të akuzuarat shpallen fajtores sipas nenit 6 të Ligjit kundër popullit dhe shtetit, zëvendësprokurori publik kërkon që të pandehurat të shpallen fajtores dhe të dënohen.

Kështu, në emër të popullit ky gjyq vendos që të shpallen fajtores në bazë të nenit 6 të Ligjit për fajin kundër popullit dhe shtetit në lidhje me nenin e parë, pikat 9 e 10 dhe nenit 8 të ligjit për konfiskimin e pasurive dhe ekzekutimin e konfiskimit të tij. Sipas këtij ligji shpallen fajtores gati të gjitha anëtares e Komitetit të Grave Nacionaliste të Prizrenit.³⁸

³⁵ AK. Dok. nr. 17\45 dhe 17\46.

³⁶ AK. Keshilli Popullor i qytetit të Prizrenit nr. 497, dt. 2 X 1945.

³⁷ Si shën. 35.

³⁸ Po aty dhe dok. nr. 497.

Në emër të ligjit, të pandehurës Laura Shmani Gjykata ia shqipton dënimin heqje lirie në kohëzgjatje prej pesë vjetëve, me kusht që dënimi t'i llogaritet nga data e marrjes në burg. Ajo dënohet edhe me humbje të të drejtave politike e qytetare, me përjashtim të atyre prindore, me konfiskimin e pasurisë- të një shtëpie në rrugën "Mareshali Tito" në Prizren.³⁹

Të pandehurën Xhyliana Mateja trupi gjykues e dënon me dy vjet heqje lirie, duke llogaritur nga dita e marrjes në burg. Ajo dënohet edhe për tri vjet humbje të të drejtave politike dhe disa qytetare, përveç atyre prindore. Ky dënim do t'i llogaritet pas vuatjes së ndëshkimit.

Të pandehurat Luçije Bashota dhe Roza Mjeda Gjykata i dënon me nga një vit heqje lirie dhe me punë të detyrueshme.

Ndërkaq, Nesibe Zhurit dhe Roza Cukit u shqiptohen dënime me nga një vit burgim me kusht, por që ndëshkimi mund të pezullohet brenda kësaj kohe. Si rrethanë lehtësuese për dënimin e tyre gjyqi merr parasysh moshën e tyre.

Në mungesë të fakteve, Gjykata e Prizrenit i liron nga akuza të pandehurat Mane Shyti, Çeçile Krasniqi dhe Mrika Gjoka.⁴⁰

Duke i konsultuar dokumentet e hetuesisë dhe të procesit gjyqësor ndaj këtyre të rejave, gjejmë shënime edhe për dënime të tjera. Kështu, pas dënitimit me burgim dhe konfiskim të pasurisë, prej tyre kërkohet të paguajnë edhe shpenzimet e gjyqit që kapnin shumën-për Laura Shmanin 2. 415 din. ndërsa për Nesibe Zhurin, Xhyliana Matejën, Roza Mjedën dhe Roza Cukin nga 2.170 din.

Veprimtaria e këtyre të rejave ishte e shkurtër sepse shpejt u bien në gjurmë organet e Sigurimit Shtetëror dhe i arrestojnë. Rëndësia e veprimtarisë së tyre qëndron në faktin se me punën e tyre patën guximin të sfidojnë regjimin në kushtet dhe rrethanat e sapokrijuara menjëherë pas luftës, dhe këtë e bënë pa marrë parasysh pasojat. Kjo veprimtari e këtyre të rejave e frikësoi pushtetin e ri, prandaj ndëshkimet kundër tyre bëheshin me metoda speciale dhe ishin të rrepta. Për këtë proces gjyqësor të grave të Prizrenit në shtypin e kohës nuk gjejmë asnjë shënim. Kjo tregon për gjoja mospërfilljen e organeve të pushtetit, në një anë, dhe pasigurinë e organeve gjyqësore, në anën tjetër.

Procesi gjyqësor dhe dënimet e anëtareve të Komitetit të Prizrenit ishin rast i mirë për organet e pushtetit për të shprehur mllëfin dhe për të ushtruar dhunën ndaj mendimit të lirë, sa herë që shqiptarët u paraqitën me kërkesa politike për ta zgjidhur çështjen kombëtare.

³⁹ AK. Nr. dok 381\45. Gradski narodni Odbor, Unutrasnji otsek, K. br. 146\211.

⁴⁰ AK. dok. Nr. 17\45. 497.

Dr. Drita BAKIJA-GUNGA

WOMEN IN THE ALBANIAN RESISTANCE 1945-1947

Summary

As part of the nation, women too experienced national deception against ideological one. The women of Kosova began showing their disappointment with the newly-created political situation in various forms. Thus, in Gjakova and Vushtrri, women's protests were organized - the first against the government - where women expressed their revolt against mobilization.

This form of organization was a response to the deception and disappointment of the promises made during the war for a just solution to the national issue. Therefore, a great number of women supportive of Antifascist Movement war who had contributed to the victory of the new government were now rising against it. This shows that the source of these demonstrations came from motherly instinct that knows no system or ideology when they are convinced that their children are being misused to serve a diabolical policy.

As a consequence of disappointment with circumstances created following World War Two to the detriment of a just solution of the national issue, in some areas of Kosova nationalist women's committees were formed. In Prizren in 1944, in the house of Nesibe Zhuri a Committee of Nationalist Women of Prizren was formed, which was later strengthened and further organized in May 1945. The members of the Committee supported with their activity that part of Albanians who continued their liberation war after 1944, regardless of the intricate circumstances and danger of involvement in such activities. In a very brief time members of this Committee carried out a number of activities to help armed resistance movement. They informed on the work of People's authorities, movements of the Yugoslav Army, collected clothes, food and light weapons and ammunition.

Through their activities they challenged the regime in the post-war newly-created circumstances and conditions, and their proud stance against torture used by the government organs bothered torturers even more, therefore they were exhorted to special methods of punishment by investigation and in sentencing heavy prison terms.

A trial and sentencing of members of the Prizren Committee were a good case for the regime to state their anger and exercise their violence against the free opinion any time Albanians came up with political demands for the solution of their national cause.